



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 7 datë 22.04.2020

P Ë R

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT: “RREGULLORE PËR ZBATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK PËR PAJISJET RADIO”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3 Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 22.04.2020 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *miratimin e dokumentit: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.*

BAZA LIGJORE:

1. Gërmat p) dhe q) të nenit 8 dhe pika 3 e nenit 79, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji 9918/2008**);
2. Ligji nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (Ligji nr.44/2015);
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
4. VKD nr. 40 datë 15.11.2019 “Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”;
- Dokumenti: “Qëndrimi i AKEP për komentet e ardhura gjatë konsultimit publik”.
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (Projekt-vendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Me Vendimin nr. 378 datë 5.6.2019, Këshilli i Ministrave ka miratuar Rregullin Teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.

Kjo VKM është përafuar pjesërisht me Direktivën 2014/53/EU (RED-Radio Equipment Directive) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të BE-së të datës 16 Prill 2014, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio dhe shfuqizimin e direktivës 1999/5/EC.

Me VKD nr. 40 datë 15.11.2019, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”. Këshillimi publik u krye nga data 15.11.2019 deri në datën 15.12.2019.

Lidhur me dokumentin e këshillimit publik, me shkresën nr. 436/4 datë 16.12.2019, kanë paraqitur disa komente sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Albselcom sh.a, për të cilat AKEP ka përgatitur një dokument me qëndrimet e tij për këto komente.

Për këtë qëllim, në zbatim të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 i ndryshuar dhe VKM Nr. 378 datë 5.6.2019, AKEP ka detyrimin e miratimit të Rregullores për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke konsideruar rëndësinë e miratimit së këtij dokumenti, si për AKEP ashtu dhe për operatorët ekonomikë që do të fusin pajisje radio në treg dhe shërbime, bazuar në gjurmën q) të nenit 8 dhe pikën 3 të nenit 79, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM Nr. 378 datë 5.6.2019, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Rregulloren për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Të miratojë dokumentin “Qëndrimi i AKEP për komentet e paraqitura gjatë këshillimit publik”, i cili jepet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky Vendim, dokumenti “Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio” dhe dokumenti “Qëndrimi i AKEP për komentet e paraqitura gjatë këshillimit publik”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR	ANËTAR	ANËTAR	ANËTAR
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Xhoana Lilaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

PËR ZBATIMIN E RREGULLIT TEKNIK

PËR PAJISJET RADIO

Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 7 datë 22.04.2020.

Neni 1

Baza ligjore

Neni 79 pika 3, neni 8 pika q) të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Kjo Rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio, miratuar me VKM Nr.378 datë 5.6.2019, për afuar pjesërisht me Direktivën 2014/53/EU “Radio Equipment Directive - RED” të Bashkimit Europian.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet nga prodhuesit, përfaqësuesit e autorizuar, importuesit, shpërndarësit e pajisjeve radio.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha pajisjet radio të importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.
3. Kjo Rregullore nuk zbatohet për:
 1. Pajisjet radio, që përdoren ekskluzivisht për aktivitete që lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe aktivitetet e shtetit në fushën e zbatimit të ligjit kundër krimit në Republikën e Shqipërisë
 2. Pajisjet radio që përdoren nga radioamatorët sipas përcaktimit të pikës 56, të nenit 1, të Radio Rregulloreve të ITU-së, përveç rastit kur pajisja është e mundshme për t’u tregtuar;
 3. Pajisje radio të cilat nuk do të konsiderohen të mundshme për t’u tregtuar si më poshtë:
 - a) Pjesët përbërëse të komponentëve për montim dhe përdorim nga radioamatorët;
 - b) Pajisjet radio të modifikuara, dhe për përdorim nga radioamatorët;
 - c) Pajisje të ndërtuara nga radioamator, për qëllime shkencore dhe eksperimentale;
 - ç) Pajisjet e marinës;
 - d) Pajisje të caktuara që përdoren në aviacionin civil në përputhje me nenin 3, të udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.
 4. Pajisje vlerësuese të personalizuar, për përdorim nga profesionistë vetëm për qëllime kërkimore dhe zhvillimore.

Neni 4

Përkufizime

1. “Pajisje radio”, është një produkt elektronik ose elektrik, i cili emeton dhe/ose merr valë radio për qëllime radiokomunikimi dhe/ose radiopërcaktimi, ose një produkt elektronik ose elektrik, i cili duhet të jetë i pajisur me një aksesor të tillë si një antenë, me qëllim emetimin dhe/ose marrjen e valëve radio, për qëllime radiokomunikimi dhe/ose radiopërcaktimi;
2. “Njoftim”, është procesi i njoftimit në AKEP, gjatë regjistrimit të tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive, që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore

- të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378.
3. “Regjistrimi i tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive” është procedura që kryejnë prodhuesit e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM Nr.378 datë 5.6.2019, në një regjistër të siguruar nga AKEP para se ato kategori të vendosen në treg;
 4. “Konfirmim regjistrimi”, është procedura që kryhet nga AKEP, pas një njoftimi të plotë dhe të saktë regjistrimi për tipet e pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378.
 5. “Regjistër (databazë) e pajisjeve radio”, është regjistri (databaza) në të cilin pasqyrohen pajisjet radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378.
 6. “Brez frekuence i harmonizuar”, është brezi i frekuencave, i cili në të gjithë ose në pjesën më të madhe të vendeve europiane është i parashikuar për përdorimin e pajisjeve radio me veçori të njëjta teknike (radiofrekuenca, modulimi, fuqia, etj).

Neni 5

Vendosja në treg dhe në shërbim e pajisjeve radio

1. Pajisjet radio të mbuluara nga Rregulli Teknik, miratuar me VKM Nr.378 datë 5.6.2019, mund të vendosen në treg dhe në shërbim, vetëm nëse janë në përputhje me Rregullin Teknik dhe nëse janë instaluar sipas specifikimeve përkatëse si dhe mirëmbahen dhe përdoren për qëllimin e synuar.
2. AKEP mund të përcaktojë kërkesa shtesë për vendosjen në shërbim dhe/ose përdorim të pajisjeve radio me qëllim:
 - a) përdorimin efektiv dhe eficient të spektrit të frekuencave;
 - b) shmangien e interferencave të dëmshme;
 - c) shmangien e shqetësimeve elektromagnetike;
 - ç) sigurimin e shëndetit publik,
 në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për administrimin e spektrit të frekuencave.
 Kërkesat shtesë mund të vendosen nga AKEP, për të zbatuar detyrime që mund të vijnë edhe nga ndryshimi i Planit të Përdorimit të Frekuencave, Autorizimet Individuale që lëshon AKEP për përdorimin e frekuencave, kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbime të komunikimeve elektronike, Vendime të Këshillit të Ministrave që kanë të bëjnë me pajisje radio, etj.
3. AKEP publikon në faqen e tij zyrtare të internetit ndërfaqet radio që synon të rregullojë, me përjashtim të ndërfaqeve radio:
 - a) të cilat janë në përputhje të plotë ose të pjesshme me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe kërkesat e ligjit mbi përdorimin e harmonizuar të spektrit të frekuencave;
 - b) të cilat mund të vihen në shërbim dhe përdorim në vendet e Bashkimit Evropian pa kufizime, referuar Sistemit Informativ të Frekuencave (EFIS) të Zyrës së Radiokomunikimit Evropian CEPT/ERO.
 AKEP publikon në faqen e tij zyrtare www.akep.al, linkun e përditësuar të ndërfaqeve radio të sistemit EFIS të CEPT-ERO.

4. Përpara vendosjes në treg dhe shërbim, prodhuesi duhet të sigurojë zbatimin e të gjitha detyrimeve sipas nenit 10 të VKM nr. 378, duke përfshirë faktin që pajisja radio të jetë e shoqëruar me udhëzime për përdoruesin, si dhe informacion mbi sigurinë, të shkruar në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, etj.

Neni 6 Prezumimi i konformitetit

1. Pajisja radio, e cila është në konformitet me standardet e harmonizuara të publikuara në Fletoren Zyrtare, ose pjesë të saj, prezumohet që është në konformitet me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në nenin 3, të VKM nr. 378 të Rregullit Teknik.
2. AKEP publikon në faqen web listën e standardeve të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7 Regjistrimi i tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore

1. Prodhuesit duhet të regjistrojnë në AKEP tipet e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378, në një regjistër të siguar nga AKEP, përpara se ato kategori të vendosen në treg.
2. Gjatë këtij regjistrimi, prodhuesi duhet të sigurojë, disa ose kur lind nevoja, të gjitha të dhënat e dokumentacionit teknik, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 5 të VKM nr. 378. Prodhuesit, për çdo pajisje radio të vendosur në tregun Shqiptar, duhet të vendosë numrin e regjistrimit, që fiksohet mbi pajisjen radio të vendosur në treg.
3. Specifikimi i kategorive të pajisjeve radio që bien në klauzolat e pikës 1 të këtij neni, si dhe elementet e dokumentacionit teknik që duhet të sigurohen në këtë rast, duke marrë në konsideratë informacionin e konformitetit të pajisjes radio, dhe pas vlerësimit të rrezikut të mos zbatimit të kërkesave thelbësore, në përputhje me praktikën e BE-së, klasifikohen si më poshtë:¹
 - a. Klasa 1: Pajisjet radio të kësaj klase mund të përdoren pa asnjë kufizim në vendet e Bashkimit Europian, EEA (European Economic Area) dhe EFTA (European Free Trade Association). Pajisjet e klasës 1 mund të përdoren pa asnjë kufizim edhe në Shqipëri. Klasa 1 e pajisjeve radio në Shqipëri, do të jetë e njëjtë me Klasën 1 të pajisjeve radio të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Europian. Kjo klasë publikohet edhe në faqen web të AKEP.
4. Njoftimi për regjistrimin e tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore, paraqitet me shkrim në AKEP, ose në formë elektronike në modulën e aplikimeve online të AKEP, sipas Formularit të Njoftimit, që

¹ Klasa 2: Pajisje radio të kësaj klase subjekt i kufizimeve në një ose me shumë shteteve të BE, EEA dhe EFTA:
- Parametrat teknike ishin të harmonizuar në vendet e EU, EEA and EFTA;
- Parametrat teknike ishin të harmonizuar në vendet e EU, EEA and EFTA dhe nuk bëjnë pjesë në Klasën 1. Shënim: Klasa 2 e pajisjeve radio është krijuar sipas direktivës së vjetër R&TTE që korrespondonte me pajisjet radio duke përdorur breza të frekuencave të harmonizuara dhe për të cilat, si pasojë, njoftimi në përputhje të Direktivës R&TTE nuk ishte i nevojshëm.

paraqitet në Aneksin 1 të kësaj Rregullore, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm.

5. Pas një njoftimi të plotë dhe të saktë regjistrimi për tipet e pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378, AKEP brenda 7 ditëve, lëshon një “Çertifikatë konfirmimi regjistrimi” sipas Aneksit 2 të kësaj Rregullore. Në rast të një njoftimi jo të plotë apo me pasaktësi, AKEP brenda 7 ditëve i kërkon subjektit plotësimin apo saktësimin e mangësive. AKEP mund të refuzojë regjistrimin e pajisjes radio, në rast se prodhuesi nuk siguron të gjitha të dhënat e dokumentacionit teknik, të përcaktuara të aneksin V të VKM nr. 378. Refuzimi nga AKEP bëhet me shkrim dhe njoftimi i refuzimit përmban arësyet e refuzimit të regjistrimit të pajisjes radio.

Neni 8

Përbërja dhe të dhënat e regjistrit

1. Regjistri (databaza) i pajisjeve radio, është regjistri me të dhënat e mëposhtme:
 - a. Numri i regjistrimit;
 - b. Data e regjistrimit;
 - c. Emërtimi i pajisjes radio (marka, tipi);
 - a. Brezi i frekuencave në të cilin operon pajisja radio (MHz);
 - b. Emri i operatorit ekonomik (prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi)
 - c. Të dhënat e kontaktit të operatorit ekonomik (adresa zyrtare postare, email, telefon, website);
 - d. Numri i dokumentit të organit vlerësues të konformitetit.
2. Numri i regjistrimit do të përmbajë këto elemente:
 - a. AL, që nënkupton Shqipërinë;
 - b. AKEP, që nënkupton Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
 - c. Vitin kalendarik;
 - d. RE, që nënkupton pajisjen radio në termin e shkurtuar në gjuhën angleze Radio Equipment;
 - e. xxxxx, është numër rendor sipas kërkesave për regjistrim.
3. AKEP publikon në faqen e tij web “Regjistrin (databazën) e pajisjeve radio” të regjistruara, në të cilin pasqyrohen pajisjet radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378. Përmbajtja e Regjistrit (databazës), paraqitet në Aneksin 3 të kësaj Rregullore.

Neni 9

Pagesat

1. Pagesat për regjistrimin e tipeve të pajisjeve radio sipas kategorive, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Subjektet që paraqesin në AKEP njoftim të plotë dhe të saktë regjistrimi të pajisjes radio, janë të detyruar të kryejnë pagesën përkatëse, brenda 15 ditësh nga data e aplikimit. Me shlyerjen e pagesës brenda këtij afati, AKEP brenda 7 ditëve do të lëshojë dokumentin e Konfirmimit të Regjistrimit.

Neni 10

Mbikqyrja dhe kontrolli i tregut për pajisjet radio

1. Mbikqyrja e tregut të pajisjeve radio bëhet në zbatim të legjislacionit në fuqi lidhur me produktet joushqimore.
2. AKEP-i dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, janë strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio, të cilët, në zbatim të VKM nr. 378, lidhin marrëveshje bashkëpunimi midis tyre.
3. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (në vijim, ISHMT), në bashkëpunim me AKEP, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet radio të mbuluara nga Rregulli Teknik, mund të vendosen në treg dhe në shërbim vetëm nëse janë në përputhje me Rregullin Teknik.
4. Objektivat kryesorë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të tregut për pajisjet radio, përcaktohen në nenin 34 të VKM nr. 378.
5. Deklaratat e konformitetit duhet të jenë të disponueshme sa herë që ato të kërkohen nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut. Për më tepër, çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar deri tek përdoruesi me deklaratën e konformitetit.
6. Në rast se pajisjet e vendosura në treg janë në mospërputhje me kushtet e përcaktuara në Rregullin Teknik miratuar me VKM nr.378, AKEP marr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP ka autoritetin të ndalojë, të kufizojë ose të tërheqë nga përdorimi pajisjet radio, që shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë interferenca të dëmshme. Në këtë rast, nëse pajisja radio gjendet e regjistruar në Regjistrin (databazën) e AKEP, AKEP bën çregjistrimin e saj nga ky Regjistër dhe njofton me shkrim operatorin ekonomik të asaj pajisje radio.
7. Pronari i pajisjeve radio nuk ka të drejtë të pengojë inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë dhe të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm sa herë që kërkohet një gjë e tillë.
8. Kur për një pajisje radio, është aplikuar një masë kombëtare e cila konsiderohet e justifikuar, AKEP do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisja radio jo në konformitet të tërhiqet ose të pezullohet nga tregu.
9. Kur është e nevojshme, për çështje të konformitetit të pajisjeve radio, AKEP dhe ISHMT bashkëpunojnë me organin vlerësues të konformitetit.
10. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, njofton autoritetin miratues çdo vit mbi aktivitetin e mbikëqyrjes së tregut, duke paraqitur një raport shoqëruar me të dhëna statistikore, si dhe të sigurojnë informacion mbi konformitetin e pajisjeve radio në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, duke përfshirë dhe kërkesat mbi identifikimin e operatorëve ekonomik.

Neni 11

Shfuqizimi i rregullores së mëparshme

Rregullorja nr. 25 datë 14.06.2012 “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”, shfuqizohet.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj.

**Qëndrimi i AKEP, për komentet e paraqitura gjatë këshillimit publik të dokumentit
“Rregullore për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, miratuar me VKD
nr. 40 datë 15.11.2019.**

- 1. Komentet e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a, paraqitur në AKEP me shkresën nr. 436/4 datë 16.12.2019 dhe qëndrimet e AKEP, jepen me poshtë:**

Koment 1:

Shoqëria Telekom Albania sh.a vlerëson se përcaktimet e rregullave teknike të propozuara në nenet e kësaj draft-rregullore nuk impaktojnë negativisht operatorët referuar me atë që parashikohet në rregulloren aktuale në fuqi.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP vlerëson komentin e Telekom Albania sh.a.

Koment 2:

Në nenin 6 pika 4, dhe nenin 9 pikat l/f, 3/e dhe 4/a2, ajo çfarë evidentohet si problematikë nga ana jonë ka të bëjë me shkrimin në gjuhën shqipe që do të përdoret në informacionin mbi sigurinë në dokumentacionin përkatës së bashku me çertifikatën e konformitetit të pajisjeve që do të importohen ose prodhohen, gjë e cila përbën një shqetësim për shoqërinë tonë pasi Telekom Albania blen pajisjet radio nga operatorë dhe furnitorë të huaj.

Për këtë arsye, Telekom Albania sugjeron që në pikat përkatëse të këtyre neneve të përmendura në paragrafin më sipër, të zëvendësohet termi "gjuhën shqipe e gjuhën anglisht".

Qëndrimi i AKEP:

Lidhur me këtë kërkesë të Telekom Albania sh.a, sqarojmë që detyrimi që pajisja radio të jetë e shoqëruar me udhëzime për përdoruesin, si dhe informacion mbi sigurinë, të shkruar në gjuhën shqipe, është vendosur në pikën 9 të nenit 10, pikën 5 të nenit 11 dhe pikën 2 b) të nenit 13 të VKM nr. 378 datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

Gjithashtu sqarojmë që detyrimi për udhëzime dhe informacion në gjuhën Shqipe, nuk e ndalon prodhuesin që ti ketë udhëzimet dhe informacionin edhe në gjuhën Angleze, apo gjuhë të tjera.

Ndërsa lidhur me gjuhën e çertifikatës së konformitetit të pajisjeve radio, sqarojmë që në paragrafin e fundit të nenit 18 të VKM nr. 378 datë 5.6.2019 citohet “*Modeli i kësaj deklarate përcaktohet në aneksin VI të këtij rregulli teknik. Deklarata EC e Konformitetit e thjeshtuar, sipas pikës 9, të nenit 10, do të përmbajë të dhënat e përcaktuara në aneksin VII, do të përditësohet vazhdimisht dhe duhet të jetë në gjuhën shqipe. Teksti i plotë i Deklaratës EC të Konformitetit duhet të jetë i disponueshëm në adresën e internetit të përcaktuar në dokumentin e Deklaratës EC të Konformitetit të Thjeshtuar, në gjuhën shqipe ose atë angleze*”.

Deklarata CE e konformitetit, e cila është një nga dokumentet më të rëndësishme shoqëruese të pajisjes radio, bazuar në paragrafin e fundit të nenit 18 të VKM nr. 378 datë 5.6.2019, ka dhënë mundësinë që ky dokument mund të jetë në gjuhën shqipe ose atë angleze.

Gjithashtu në Draft-Rregulloren e AKEP, në pikën 2 të nenit 16 të saj, është cituar që deklarata CE e konformitetit mund të jetë në gjuhën Shqipe ose e përkthyer në gjuhën Shqipe, dhe përmbajtja e saj të jetë sipas përcaktimeve të nenit 18 të VKM nr. 378 datë 5.6.2019.

Sa më sipër, bazuar në përcaktimet e VKM nr. 378 datë 5.6.2019, pajisja radio duhet të jetë e shoqëruar me udhëzime për përdoruesin, si dhe informacion mbi sigurinë, të shkruar në gjuhën shqipe, ndërsa deklarata CE e konformitetit mund të jetë në gjuhën Shqipe ose Angleze.

Koment 3:

Çështja tjetër lidhet me aspektet e vlerësimit të konformitetit të pajisjes sipas nenit 7 të draft-rregullores në të cilën parashikohet që ky vlerësim do të kryhet nga një palë e tretë (Organi i vlerësimit të konformitetit).

Vlerësimi i konformitetit ashtu siç përcaktohet në këtë nen do të çojë në një rritje të kostove për operatorët, duke krijuar në këtë mënyrë kosto shtesë të lidhura me procesin e miratimit të konformitetit të pajisjeve nga këto palë të treta. Organi përkatës i vlerësimit të konformitetit (duke qenë një sipërmarrës privat me natyrë fitimprurëse i regjistruar si i tillë në QKB) do të aplikojë tarifën e tij përkatëse komerciale për kryerjen e këtyre procedurave me kosto më të larta për operatorët, referuar kjo me praktikën që ndiqet aktualisht sipas përcaktimeve të nenit 5 të Rregullores aktuale ku AKEP është organi përgjegjës për njohjen e procesit të konformitetit të pajisjeve fundore radio.

Për sa më sipër, Telekom Albania sugjeron që ky proces të vazhdojë të kryhet nga ana e AKEP ashtu siç është praktika që ndiqet aktualisht sipas rregullore në fuqi.

Qëndrimi i AKEP:

Lidhur me këtë sugjerim të Telekom Albania sh.a, sqarojmë që me Rregulloren nr. 25 datë 14.06.2012 “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”, AKEP ka kryer vetëm njohjen e konformitetit për pajisjet radio dhe jo vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio. Vlerësimi i konformitetit të pajisjeve radio është kryer nga organe të akredituara në vendet e BE-së dhe AKEP bënte vetëm njohjen e këtij vlerësimi.

Në pikën 2 a) të nenit 13 të VKM nr. 378 datë 5.6.2019, përcaktohet që përpara bërjes së disponueshme të pajisjes radio në treg, shpërndarësi verifikon që pajisja radio mban markimin CE të kërkuar. Meqenëse pajisja radio do të përmbajë markimin CE, kuptohet që ky markim mund të bëhet vetëm pasi të jetë kryer vlerësimi i konformitetit të pajisjeve radio nga një organ i akredituar në vendet e BE-së.

Ndërsa organi i akredituar i vlerësimit të konformitetit në Shqipëri, i cili do të jetë person juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, do të kryejë vlerësimin e konformitetit

të pajisjeve radio nëse janë në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 378 datë 5.6.2019 apo impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të kësaj VKM-je.

Sqarojmë që VKM nr. 378 datë 5.6.2019 është përafuar pjesërisht me direktivën 2014/53/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të BE-së të datës 16 Prill 2014, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio.

Sa më sipër, bazuar në VKM nr. 378 datë 5.6.2019, AKEP nuk mund të kryejë vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio, përveçse në rast se AKEP akreditohet si organ i vlerësimit të konformitetit, por për këtë AKEP-it i nevojiten laboratorë testimi të pajisjeve radio në të gjitha brezat e frekuencave, staf i kualifikuar dhe trajnuar për këtë qëllim, çertifikatat ISO përkatëse, të arrijë të akreditohet për këtë qëllim, etj.

2. Komentet e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, paraqitur në AKEP me shkresën nr. 436/6 datë 16.12.2019 dhe qëndrimet e AKEP, jepen me poshtë:

Koment 1:

Është e kuptueshme se sipas procesit të ri të përshkruar në rregullore, gjithë pajisjet të cilat janë në përputhje me standardet e harmonizuara të përmendura në VKM nr. 378, nuk do të jetë e nevojshme të pajisen me një certifikatë konformiteti, ndërkohë që për rastet kur ka mospërputhje me këto standardë, vlerësimi i konformitetit është i nevojshëm dhe subjekti që do të importojë/vendosë në përdorim pajisjen do të duhet të drejtohet tek “Organi i vlerësimit të konformitetit”. Për sa jemi në dijeni, ky organ nuk është krijuar ende dhe kjo mund të sjellë mangësi për procesin, siç ai përshkruhet në VKM 378 dhe në rregullore.

Për sa më sipër, Vodafone Albania sh.a gjykon se AKEP si organ që ka ekspertizën e nevojshme, mund të vendoset përkohësisht në rolin e “Organit të vlerësimit të konformitetit”, deri sa ky i fundit të jetë akredituar nga Autoriteti miratues.

Qëndrim 1:

VKM nr. 378 ka përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat e AKEP, të ndryshme nga përgjegjësitë dhe kompetencat e “Organit të vlerësimit të konformitetit”. AKEP nuk mund të vendoset në rolin e “Organit të vlerësimit të konformitetit”, për sa kohë që në VKM 378 kërkohet që ky organ të jetë një organ i palës së tretë, i pavarur nga organizata ose pajisjet radio që vlerëson, si dhe të ketë kapacitetet dhe njohuritë e nevojshme për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio.

3. Komentet e sipërmarrësit Albtelcom sh.a, paraqitur në AKEP me shkresën nr. 436/5 datë 16.12.2019 dhe qëndrimet e AKEP, jepen me poshtë:

Komentet e Albtelcom konsistojnë kryesisht në çështje, për të cilat Albtelcom nuk është i sigurtë se e ka kuptimin e duhur as në dritën dhe interpretimin e VKM nr. 378 dhe për të cilat lutet të ketë qartësimin apo korigjimin mbi kuptueshmërinë e tyre. Si të tilla, Albtelcom rendit:

Koment 1:

- Nga sa kemi kuptuar nga draft rregullorja dhe nga VKM nr. 378, pajisjet radio me markimin CE supozohen të përmbushin kërkesat thelbësore nga draft rregullorja dhe nuk do ti nënshtrohen procesit të njohjes së konformitetit dhe as nuk do të regjistrohen pranë AKEP?!

Qëndrim 1:

Në piken 1 b) të nenit 20 të VKM nr. 378 përcaktohet që markimi CE i konformitetit shoqërohet nga numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar, i cili i është nënshtuar procedurës së vlerësimit të konformitetit bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë, në përputhje me aneksin IV të kësaj VKM-je.

Gjithashtu në nenin 25 të VKM 378 përcaktohet që kur një organ i vlerësimit të konformitetit vërteton konformitetin e tij me kriteret e përcaktuara të standardeve përkatëse të harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, prezumohet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 24, të këtij rregulli teknik, për aq kohë sa standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Me këto përcaktime të VKM nr. 378 është e qarte që për pajisjet e markuara CE (e shoqëruar nga numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar) nuk ka pse të kryhet një vlerësim i dytë konformiteti në Shqipëri dhe kësaj as të regjistrohet në AKEP, pasi vetëm pajisjet që kanë përputhshmëri të ulet me rregullin teknik të VKM 378, do të regjistrohen në AKEP pasi të kenë kaluar procedurën e vlerësimit të konformitetit, tek organi i vlerësimit të konformitetit.

Koment 2:

- Cilët janë subjektet që bëjnë regjistrimin në AKEP? VKM nr. 378 (neni 5) dhe neni 11 i draft rregullores i referohen “*prodhuesit*” ndërsa formulari i njoftimit bashkëngjitur draft rregullores i referohet “*operatorit ekonomik (prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi ose shpërndarësi i pajisjes radio)*”.

Qëndrim 2:

Në pikën 1 të nenit 5 të VKM nr. 378, citohet që duke filluar nga data 1.1.2020, prodhuesit duhet të regjistrojnë tipat e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, në një regjistër të siguruar nga AKEP-i para se ato kategori të vendosen në treg.

Ndërsa në nenin 14 të VKM nr. 378 përcaktohet që një importues ose shpërndarës konsiderohet prodhues, për qëllime të këtij rregulli teknik, dhe do të jetë subjekt i detyrimeve të prodhuesit, sipas përcaktimeve të nenit 10, kur ai vendos një pajisje radio në treg nën emrin e tij ose markën e

tij tregtare ose modifikon pajisjen radio, të vendosur në treg, në mënyrë të tillë, që pajisja radio të mos jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik.

Gjithashtu, kjo është ritheksuar pikën 5 të nenit 9 të draft-Rregullores së AKEP.

Kjo është arsyeja pse AKEP në formularin e njoftimit, i ka vendosur edhe prodhuesit, edhe përfaqësuesin e autorizuar, importuesit ose shpërndarësit e pajisjeve radio.

Koment 3:

- Përkufizimi sipas draft rregullores i termit “prodhues” nuk përcakton nëse i referohet prodhuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo prodhuesit të regjistruar për të kryer aktivitetin e tyre prodhues në territorin e Republikës së Shqipërisë!

Oëndrim 3:

Përkufizimi i “Prodhuesit” në draft-Rregulloren e AKEP është i njëjtë me përkufizimin e pikës i) të nenit 2 të VKM nr. 378.

Koment 4:

- Cilat pajisje radio kërkojnë regjistrimin pranë AKEP? Albtelcom nuk është i qartë mbi rastet se kur draft Rregullorja parashikon regjistrimin pranë AKEP të pajisjeve radio? Do të regjistrohen vetëm pajisjet që do duhet të kalojnë në procesin e njohjes së konformitetit? Cilat pajisje do të duhet të nënshtrohen procesit të vlerësimit të konformitetit.

Oëndrim 4:

Në pikën 1 të nenit 5 të VKM nr. 378, përcaktohet që duke filluar nga data 1.1.2020, prodhuesit duhet të regjistrojnë tipat e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, në një regjistër të siguruar nga AKEP-i para se ato kategori të vendosen në treg.

AKEP ka vetëm detyrimin të regjistrojë në një regjistër pajisjet radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, ndërsa vlerësimi i konformitetit për nivelin e pajtueshmërisë me kërkesat e nenit 3 të VKM nr. 378, kryhet nga një organ i akredituar.

Koment 5:

- Çfarë roli ka lista e publikuar nga AKEP e ndërfaqeve radio?

Oëndrim 5:

Në pikën 1 të nenit 8 të VKM nr. 378, përcaktohet që AKEP-i publikon në faqen e tij zyrtare ndërfaqet radio që synon të rregullojë, me përjashtim të ndërfaqeve radio:

a) të cilat janë në përputhje të plotë ose të pjesshme me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe kërkesat e ligjit mbi përdorimin e harmonizuar të spektrit të frekuencave;

b) të cilat, në përputhje me rregullat zbatuese të përmendur në pikën 2, korrespondojnë me pajisjet radio, të cilat mund të vihen në shërbim dhe përdorim në vendet e Bashkimit Evropian pa kufizime.

2. Me qëllim vlerësimit e vendosjes në shërbim të pajisjes radio, operatori ekonomik duhet të verifikojë në Sistemin Informativ të Frekuencave (EFIS) të Zyrës së Radiokomunikimit Evropian CEPT/ERO, në të cilin specifikohen ndërfaqet radio të disa vendeve evropiane.

Koment 6:

- Vlerësimi për përputhshmërinë apo nivelin e ulët të përputhshmërisë me kërkesat thelbësore mbetet në diskrecion të operatorëve të komunikimeve elektronike?

Oëndrim 6:

Operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë kryesisht përdorues të pajisjeve radio, megjithatë në pikën 1 të nenit 7 të VKM nr. 378 përcaktohet që pajisjet radio mund të vendosen në shërbim dhe në përdorim vetëm nëse janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik, dhe nëse janë instaluar sipas specifikimeve përkatëse si dhe mirëmbahen dhe përdoren për qëllimin e synuar.

Gjithashtu në pikën 1 b) të nenit 15 të VKM nr. 378 përcaktohet që operatorët ekonomikë, mbi bazën e kërkesës të strukturës së mbikëqyrjes së tregut, do të identifikojnë edhe çdo operator ekonomik që ata kanë furnizuar me pajisje radio.

Pra operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet të jenë të kujdesshëm që të kërkojnë nga prodhuesit, importuesit ose shpërndarësit e pajisjeve radio, zbatimin e detyrimeve të VKM nr. 378, pra që pajisja radio të ketë ose markimin korrekt CE, ose ti jete vlerësuar konformiteti nga një organ vlerësues dhe të jetë regjistruar në AKEP si pajisje radio.

Në rastet kur operatori i rrjeteve të komunikimeve elektronike, do të jetë përfaqësues i autorizuar nga prodhuesit, importues apo shpërndarës në treg i pajisjeve radio, ai do të nënshtrohet edhe detyrimeve të tjera të VKM nr. 378.

Koment 7:

- Çfarë nënkuptohet me nivel të ulët përputhshmërie? A ka një referencë konkrete se sa kërkesa duhet të ketë përmbushur apo mos përmbushur pajisja për tu konsideruar se ka një nivel të ulët përputhshmërie.

Qëndrim 7:

Në VKM nr. 378 përcaktohet që vlerësimi i konformitetit të pajisjeve radio do të kryhet nga një organ i akredituar. Është ky organ që përcakton një nivel e plotë apo të ulët të përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3 të VKM nr. 378.

Koment 8:

- Seksioni 4 i Formularit të Njoftimit bashkëngjitur draft rregullores nënkupton se për regjistrimin pranë AKEP duhet kaluar paraprakisht procesi i akreditimit ku referohet edhe VKM 378. Pra, nga përcaktimi në seksionin 4, nënkuptohet që regjistrimi në AKEP bëhet duke iu nënshtruar paraprakisht procesit të akreditimit.

Qëndrim 8:

Në seksionin 4 të formularit të njoftimit kërkohet informacion mbi vlerësimin e konformitetit sipas kërkesave thelbësore të VKM nr. 378. Këtë informacion aplikuesi e siguron nga organi i vlerësimi të konformitetit.

Koment 9:

- Ndërkohë, neni 7, parashikon se procesit të vlerësimit të konformitetit i nënshtrohen vetëm prodhuesit?

Qëndrim 9:

Meqenëse pyetja është e njëjtë me komentin 2 të Albtelecom, përgjigja është e njëjtë me qëndrimin 2 të AKEP.

Koment 10:

- Cilat pajisje radio kërkojnë ti nënshtrohen procedurës së vlerësimit të konformitetit nga organi vlerësues i konformitetit.

Qëndrim 10:

VKM nr. 378 ne pikën 1 të nenit 1, përcakton që ky rregull teknik zbatohet për pajisjet radio. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni përcaktohet që rregulli teknik zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri. Ndërsa pika 3 e këtij neni përcakton cilat pajisje përjashtohen.

Koment 11:

- Neni 6, pika 4 e draft rregullores së AKEP parashikon detyrime për prodhuesin. Nuk është e qartë nëse ky nen është i vlefshëm për prodhuesit që janë të regjistruar për të ushtruar aktivitetin e tyre në Shqipëri apo synon të rregullojë edhe prodhuesit jashtë kufijve. Duhet të specifikohet dhe të qartësohet se cilët prodhues janë subjekt i detyrimeve nga kjo draft rregullore dhe VKM, prodhuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, ato jashtë kufijve apo kudo qoftë prodhuesi. Që këtë, duhet të specifikohet dhe qartësohet procedura psh se si mund të materializohet plotësimi i detyrimit për shoqërimin e pajisjes radio me udhëzimet për përdoruesin dhe informacione për sigurinë etj të shkruar në gjuhën shqipe, veçanërisht nëse me prodhuesin do të kuptohet edhe ‘prodhuesi’ jashtë kufijve të territorit.

Qëndrim 11:

Në pikën 2 të nenit 1 të VKM nr. 378, përcaktohet që rregulli teknik zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri. Detyrimet për prodhuesin në draft-Rregulloren e AKEP janë të njëjta me detyrimet e tij të përcaktuara në VKM nr. 378.

Koment 12:

- Përcaktimet e nenit 9 po ashtu kanë nevojë të sqarohen në lidhje me detyrimet e palëve dhe mënyrën se si duhet të garantohet secila nga palët mbi përmbushjen e këtyre detyrimeve nga prodhuesi.

Qëndrim 12:

Detyrimet e prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit, në nenin 9 të draft-Rregullores së AKEP janë të njëjta me përcaktimet e VKM nr. 378 dhe janë vendosur të njëjta në draft-Rregulloren e AKEP në mënyrë që aty të jenë të qarta përcaktimet dhe detyrimet jo vetëm të AKEP por edhe të operatoreve ekonomikë, për sa kohë ekziston detyrimi për regjistrim në AKEP të pajisjeve radio me nivel të ulët pajtueshmërie me kërkesat thelbësore të kësaj VKM-je.

Koment 13:

- Ndërkohë që është parashikuar që kjo rregullore hyn në fuqi me 01.01.2020 akoma jemi të panjohur me entitetet që do të kryejnë procesin e vlerësimit të konformitetit të cilat do të gjykojnë edhe mbi nivelin e ulët të përputhshmërisë sipas kërkesave thelbësore.

Oëndrim 13:

Në AKEP nuk është paraqitur ndonjë komunikim shkresor apo informacion mbi organe të akredituara në Shqipëri për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio. Megjithatë për të marrë informacion Albtelecom mund ti drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, strukturë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Koment 14:

- Çfarë do të ndodhë nëse ka ndonjë pajisje tashmë të instaluar në secilin prej segmenteve të rrjetit që nuk përputhet me kërkesat e rregullores, a ka ndonjë datë finale për zëvendësimin?

Oëndrim 14:

Me Rregulloren nr. 25 date 14.06.2012, AKEP ka kryer vetëm njohjen e konformitetit për pajisjet radio për subjektet që kanë paraqitur aplikim në AKEP dhe jo vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio. Në Rregulloren nr. 25, ishte kërkesë strikte që aplikimi për njohje të konformitetit të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit dhe frekuencat e pajisjeve radio të jenë në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.

Pra, AKEP ka njohur vetëm konformitetin e pajisjeve radio që plotësojnë këto dy kritere thelbësore por edhe kriteret e tjera të Rregullores dhe VKM-së së mëparshme nr. 546 datë 13.06.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre” të bazuar në direktivën RTT&E 1995/5/EC të Bashkimit Europian. Vendosija e pajisjeve të tilla, nëse është e vërtetë, është në përgjegjësinë e përdoruesit.

Në rast se përdoruesi konstaton papërputhshmëri të pajisjes radio me kërkesat e Rregullit Teknik të VKM 378 dhe Rregullores së AKEP për zbatimin e këtij rregulli teknik, duhet ti drejtohet prodhuesit, importuesit apo shpërndarësit, për sqarime dhe respektim të kontratave të shit-blerjes mes palëve, në zbatim të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Koment 15:

- Nuk është e qartë ku do mund të gjenden pajisjet/kriterete EU-së të publikuara në faqen e internetit www.akep.al, a është e mundur të organizohet një link dhe menu e specifikuar/i dedikuar për këtë lloj informacioni (si psh radio.akep.al) (neni 5 pika 4, neni 6 pika 3, neni 12 pika 3).

Oëndrim 15:

Sistemi Informativ i Frekuencave (EFIS) të Zyrës së Radiokomunikimit Evropian CEPT/ERO, në të cilin specifikohen ndërfaqet radio të disa vendeve evropiane, është përherë i disponueshëm në faqen zyrtare të tyre. Linku që do të publikojë AKEP në faqen e tij të internetit, është i njëjtë me linkun e EFIS dhe mund ta gjeni në faqen web www.efis.dk. Kujtojmë që Shqipëria bën pjesë në Rajonin 1 të ITU dhe zbaton përcaktimet e CEPT për çështjet e frekuencave me të cilat punojnë pajisjet radio. Meqenëse Plani kombëtar i Frekuencave është i bazuar në vendimet/rekomandimet e CEPT, AKEP do të publikojë të njëjtat ndërfaqe radio që publikon EFIS.

Koment 16:

- A konsiderohen modemat xDSL, ONT`s dhe pajisje të tjera Wi-Fi brenda qëllimit të kësaj rregullorje?

Qëndrim 16:

Qëndrimi i AKEP për këtë koment është i njëjtë me qëndrimin në koment 10.

VKM nr. 378 në pikën 1 të nenit 1, përcakton që ky rregull teknik zbatohet për pajisjet radio. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni përcaktohet që rregulli teknik zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri. Ndërsa pika 3 e këtij neni përcakton cilat pajisje përjashtohen. Pra, pajisje të tilla janë objekt i VKM nr. 378 dhe Rregullores së AKEP.

Koment 17:

- Në lidhje me software-in në pajisje, a kualifikon plotësisht markimi CE software-in dhe gjithçka tjetër?
- Sipas draftit të ri të VKM nr. 378 Aneksi V, pika a, versione të software ose firmware që ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore, po ashtu edhe Aneksi VI, pika 8, në rastet kur është e aplikueshme, përshkrimi i aksesoreve ose komponenteve, duke përfshirë software-et të cilat bëjnë të mundur operimin siç duhet të pajisjes radio mbuluar dhe nga deklarata e konformitetit BE. Duke qenë se software-et dhe firmware-et ndryshojnë vazhdimisht, nuk është bërë e qartë në dokument nëse duhet ri-aplikuar për certifikate konformiteti nëse kjo certifikatë është marre njëherë?

Qëndrim 17:

Është organi i vlerësimit të konformitetit që shqyrton përputhshmërinë me kërkesat teknike të VKM nr. 378 të pajisjeve radio, përfshirë software ose jo. AKEP nuk ka kompetencën dhe as mundësinë ta vlerësojë një gjë të tillë.

Koment 17:

- Duke qenë se kjo është një draft rregullore e re dhe jo një amendim i rregullores ekzistuese, bazuar në një vendim të ri të këshillit të ministrave, dhe për të cilat ka një sërë paqartësish që lidhen me zbatimin korrekt të saj, gjykojmë se koha e hyrjes në fuqi e parashikuar për datën 01.01.2020 është një datë shumë e shpejtë për hyrjen në fuqi për industrinë tonë dhe aktorët subjekti i gjithë këtij procesi.

Qëndrim 18:

VKM nr. 378 ne piken 1 te nenit 5 ka përcaktuar që duke filluar nga data 1.1.2020, prodhuesit duhet të regjistrojnë tipat e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, në një regjistër të siguruar nga AKEP-i para se ato kategori të vendosen në treg.

Kjo datë nuk mund të ndryshohet nga AKEP. Për këtë shqetësim Altelecom mund tu drejtohet organeve kompetente. Sqarojmë gjithashtu që nga muaji korrik 2019 nuk ka pasur aplikime në AKEP për njohje të vlerësimit të konformitetit, pra është e dukshme që nuk ka nxitim apo nevojë të shtuar nga operatorët për çështje të konformitetit të pajisjeve radio.

Koment 19:

Për sa më sipër, Altelecom kërkon që përpara se të finalizohet miratimi i kësaj rregulloreje, të konsiderohen për tu sqaruar çështjet e mësipërme, të shikohet mundësia për organizimin e një takimi të përbashkët me përfaqësues nga Ministria, AKEP dhe operatorë të tjerë në mënyrë që të sigurohemi se të gjitha palët në industri kemi të njëjtin kuptim në lidhje me parashikimet në këtë draft rregullore dhe VKM nr.378

Qëndrim 19:

AKEP shprehet i gatshëm në çdo kohë për takime, por miratimi i Rregullores për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio është detyrim për AKEP nga VKM nr. 378.